

## SKEDË INFORMATIVE

### Mundësi për aplikim të bashkive në thirrjen “Citizens’ Engagement and Participation 2026 (CERV-2026-CITIZENS-CIV)”

Kjo grup-thirrje ka 3 thirrje për aplikim:

- **Supporting free, fair and inclusive electoral processes (CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-ELECTIONS)**
- **Promoting citizens’ active engagement and democratic participation in public policymaking, beyond elections, as well as broader civic engagement (CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-BEYOND-ELECTIONS)**
- **Countering the spread of disinformation and foreign information manipulation and interference (FIMI) in democratic debate and processes (CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-DISINFORMATION-FIMI)**

#### Synimi i Thirrjes:

Kjo thirrje synon të mbështesë projekte që përfshijnë drejtpërdrejt qytetarët. Këto projekte do të mbledhin një numër personash me prejardhje dhe gjini të ndryshme në aktivitete të lidhura drejtpërdrejt me politikën e Bashkimit Evropian, duke u dhënë atyre mundësinë të marrin pjesë aktive në procesin e hartimit të politikave të BE-së dhe, në këtë mënyrë, të kontribuojnë në jetën demokratike dhe qytetare të BE-së. Projektet do të inkurajojnë mirëkuptimin e qytetarëve, përfshirë të rinjtë, mbi procesin e hartimit të politikave, duke treguar në praktikë se si mund të angazhohen në jetën demokratike të BE-së dhe duke u mundësuar atyre të shprehin dhe të shkëmbejnë publikisht pikëpamjet e tyre në të gjitha fushat e veprimit të BE-së.

Kjo thirrje ofron mundësinë për të mbuluar gjerësisht një sërë fushash të politikave dhe për të kontribuar në promovimin e vlerave të BE-së, sundimit të ligjit, barazisë gjinore, të drejtave themelore dhe demokracisë.

Projektet duhet të mbështesin pjesëmarrjen demokratike, përfshirë përmes nxitjes dhe organizimit të reflektimeve, debateve apo aktiviteteve të tjera. Ato duhet gjithashtu të propozojnë zgjidhje praktike që mund të zbatohen përmes bashkëpunimit ose koordinimit në nivel evropian, të mbështesin shkëmbimin e praktikave më të mira dhe të sigurojnë një lidhje konkrete me procesin e hartimit të politikave.

#### Fushat e veprimit të thirrjes:

Çdo aplikim projekti në kuadër të kësaj thirrjeje duhet të trajtojë vetëm një nga temat/prioritetet e mëposhtme:

##### 1. **CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-ELECTIONS:**

Mbështetja e proceseve zgjedhore të lira, të drejta dhe gjithëpërfshirëse (duke u fokusuar në informimin mbi zgjedhjet dhe të drejtat zgjedhore, veçanërisht për qytetarët e BE-së

që lëvizin, në respekt të plotë të kompetencave të shteteve anëtare në organizimin e zgjedhjeve).

2. **CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-BEYOND-ELECTIONS:**

Promovimi i angazhimit aktiv të qytetarëve dhe pjesëmarrjes demokratike në hartimin e politikave publike, përtej proceseve zgjedhore, si dhe nxitja e angazhimit më të gjerë qytetar.

3. **CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-DISINFORMATION-FIMI:**

Kundërshtimi i përhapjes së dezinformimit dhe manipulimit të informacionit nga aktorë të huaj, si dhe ndërhyrjeve të jashtme (FIMI) në debatin dhe proceset demokratike.

**Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:**

Aplikuesit duhet të jenë bashki nga vendet e BE-së ose vendet e lidhura me programin CERV, ku bën pjesë edhe Shqipëria.

Propozimet duhet të paraqiten nga një konsorcium me **të paktën dy aplikantë** (përfitues; jo entitete të lidhura dhe as partnerë të asociuar), i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- përfituesit duhet të jenë subjekte publike ose organizata private, të themeluara ligjërisht në një nga vendet e pranueshme, ose një organizatë ndërkombëtare;
- përfituesit të jone subjekte të dy shteteve të ndryshme
- Organizatat me qëllim fitimi duhet të paraqesin aplikime në partneritet me subjekte publike ose organizata private jofitimprurëse.

**Aktivitetet të pranueshme:**

Aktivitetet e projekteve duhet të strukturohen sipas rregullave të buxhetit dhe kostove të pranueshme (seksioni 10). Nuk financohen aktivitetet që mbështesin parti politike specifike ose që kanë karakter propagandistik/prozelitist.

**Prioriteti 1**

Ndahet në dy nën-prioritete:

**Nën-prioriteti 1.1 (Fokus: Organizatat e Shoqërisë Civile – OShC)**

- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat zgjedhore (sidomos të rinjtë).
- Mbështetje për sigurinë e kandidatëve dhe përfaqësuesve politikë (online/offline).
- Promovimi i përdorimit të përgjegjshëm të teknologjive të reja (sidomos AI) në zgjedhje.
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në financimin politik (p.sh. reklamat politike, kriptovalutat).
- Zhvillimi i mjeteve për zbatimin e rregullave për reklamat politike.
- Vëzhgimi i zgjedhjeve dhe trajnimi i vëzhguesve.

## **Nën-prioriteti 1.2 (Fokus: Institucionet Publike Kombëtare)**

- Forcimi i integritetit dhe sigurisë së proceseve zgjedhore (p.sh. kundër ndërhyrjeve të huaja dhe sulmeve kibernetike).
- Përdorimi i teknologjisë dhe AI në mënyrë të sigurt dhe transparente në zgjedhje.
- Trajtime për administratën zgjedhore mbi standardet, menaxhimin e riskut dhe praktikat më të mira.
- Shkëmbim përvojash dhe trajtime mbi zbatimin e rregullores për reklamat politike.

## **Përiudha e zbatimit të projekteve**

Projektet duhet të zhvillohen brenda periudhës nga 12 deri në 24 muaj (zgjatja e periudhës së zbatimit të projekteve janë të mundshme, nëse janë të justifikueshme).

## **Cili është buxheti i thirrjes për secilën bashki:**

**Buxheti minimal** për një projekt është **të paktën 75,000 EUR**. Thirrja ka një buxhet të përgjithshëm prej 30 milionë EUR, të cilat do të shpërndahen bazuar në projektet e miratuara.

## **Si bëhet aplikimi:**

Dorëzimi i propozimit bëhet në 3 pjesë:

### **Pjesa A**

Përfshin informacionin administrativ mbi organizatat aplikuese (koordinatori i ardhshëm, përfituesit, entitetet e lidhura dhe partnerët e asociuar), si dhe buxhetin e përmbledhur të projektit. Plotësohet drejtpërdrejt online.

### **Pjesa B – Përshkrimi i veprimit**

Mbulojnë përmbajtjen teknike të propozimit. Duhet të shkarkohet modeli i detyrueshëm në Word nga Sistemi i Dorëzimit, të plotësohet dhe të ngarkohet si dokument PDF.

**Pjesa C** - përmban të dhëna shtesë mbi projektin dhe kontributin e tij në treguesit kryesorë të performancës (KPI) të programit të BE-së. Plotësohet drejtpërdrejt online.

## **Kur është afati i fundit:**

Afati i fundit për aplikimet në këto thirrje është më **29 Prill 2026, ora 17:00** (ora e Brukselit).

## **Link-et e Thirrjeve:**

1. <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-ELECTIONS>
2. <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-BEYOND-ELECTIONS>
3. <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-CITIZENS-CIV-ENGAGEMENT-DISINFORMIMI>